

KONTRATË PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË

“Dipingo Albania”

Sot në Shkodër, me datë 14 Shtator 2024, Anëtarët Themelues:

1. **Z. Redi Doçi**, i biri i Shaqir dhe Lindita, lindur më 29.10.1983 në Shkodër dhe banues në Shkodër, me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numër personal I31029057T.
2. **Z. Olmo Doçi**, i biri i Shaqir dhe Lindita, lindur më 26.05.1987 në Shkoder dhe banues në Shkodër, me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numër personal I70526009I.

Të dy së bashku me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të shprehur nëpërmjet kësaj kontrate themelimi, ranë dakort për krijimin e shoqërisë së thjeshtë “Dipingo Albania” me kushtet e mëposhtme.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky akt rregullon pozitën juridike të shoqërisë, marrëdhëniet e themeluesve, dhe organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 1

Shoqëria “Dipingo Albania” themelohet si shoqëri e thjeshtë, bazuar në dispozitat 1074-1112 të Kodit Civil të Republikës të Shqipërisë.

Shoqëria e thjeshtë është një kontratë midis dy apo më shumë personave që bien dakort për të ushtruar aktivitet ekonomik me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij.

Selia e saj ndodhet në adresën: Rruga “Kolë Idromeno”, Lagjia “Vasil Shanto” Zona Kadastrale 8594, nr pasurie 274, Shkodër.

NENI 2

Veprimtaria e shoqërisë bazohet në standartet e kësaj Kontrate Themelimi si dhe legjislacionit shqiptar në fuqi. Themeluesit e saj mbajnë përgjegjësi vetëm për detyrimet që krijon Shoqëria e Thjeshtë.

NENI 3

Menjëherë sapo të bëhet regjistrimi i shoqërisë në QKB, nga Anëtarët Themelues do të derdhet kapitali i shoqërisë në shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë, ku:


50.000(pesëdhjetë mijë) lekë nga z. **Redi Doçi**

dhe

50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë do të derdhen nga Z. **Olmo Doçi**.

Për regjistrimin e shoqërisë të thjeshtë kjo shumë do të depozitohet në llogarinë e shoqërisë së re pranë të njëjtës Bankë.

NENI 4



OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria e thjeshtë do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Lyerje Fasada. Rregullime fasada. Punime Gipsi.

NENI 5

Shoqëria e thjeshtë do të ushtrojë aktivitetin me një afat kohor të pakufizuar në kohë. Veprimtaria e shoqërisë do të fillojë menjëherë pas regjistrimit të Shoqërisë së Thjeshtë "Dipingo Albania" në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU I

MARRËDHËNIET EKONOMIKE FINANCIARE

NENI 6

BURIMET FINANCIARE

Shoqëria krijon burimet e saj financiare nga ushtrimi i veprimtarisë tregtare sipas objektit të përcaktuar në këtë kontratë.

Fitimi i realizuar do të shpërndahet midis anëtarëve themelues. Fitimi është lirisht transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i anëtarëve themelues në vlerën 100.000 (dhjetë mijë) lekë.

Kapitali themeltar i anëtarëve themelues ndahet në 2 kuota dhe përkrahët si mëposhtë:

1. Z. **Redi Doçi** zoteron 1 kuota në masën 50% të vlerës së kapitalit themeltar, me vlerë 50,000(pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Z. **Olmo Doçi** zoteron 1 kuota në masën 50% të vlerës së kapitalit themeltar, me vlerë 50,000(pesëdhjetë mijë) lekë.

Vlerësimi i kapitalit themeltar është bërë nga antëtarët themelues me rastin e themelimit të kësaj shoqërie dhe nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi, dhe ishte nënshkruar prej tyre pa rezerva.

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij, janë të transferueshme si ndërmjet anëtarëve themelues ashtu edhe përkundrejt personave të tretë.


Transferimi i kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratim të anëtarëve themelues dhe me akt noterial.

Në qoftë se njëri nga anëtarët themelues dëshiron të shesë kuotat e kapitalit të tij, duhet të respektojë të drejtën e parblerjes nga anëtarët e tjerë, ose aprovimin e tyre unanim për shitjen e pjesës së tij një subjekti tjetër.

Vlerësimi i kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga anëtarët në një marrëveshje të vecantë ose një nga ekspertët kompetentë i caktuar nga anëtarët.



NENI 8



Shoqëria krijon fondet e saj për zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit.

Përbërja e fondeve, burimet financiare të tyre caktohen nga asambleja e anëtarëve.

Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

KREU II

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

NENI 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Anëtarëve themelues;
2. Administratorët e Shoqërisë.

Anëtarët themelues kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e anëtarëve.

Anëtarët mund të marrin pjesë në administrimin e veprimtarive ekonomike-tregtare të shoqërisë, në përputhje me këtë kontratë.

Të kërkojnë dhe tu jepen të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë- si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga shoqëria (pasqyra vjetore, bilanci, libra llogarie e tjerë).

Të bëjnë propozime dhe t'i paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblesë së Shoqërisë.

Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë.

NENI 10


Anëtarët themelues kanë këto detyra kryesore:

- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë.
- Të respektojnë detyrimet e caktuara nga Asambleja ose nga Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë.
- Të depozitojnë kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe me vendimet e Asamblesë (për fondin rezervë nëse parashikohet apo vendoset në vijim).
- Të regjistrojnë shoqërinë pranë QKB.
- Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, infrastrukturën e nevojshme, etj.
- Të sigurojnë kushtet për specializimin e pandërprerë të personelit ndihmës, të asistentëve, gjithnjë në funksion të rritjes së nivelit dhe cilësisë së veprimtarisë së ushtruar nga ana e shoqërisë.
- Të menaxhojnë marketingun dhe reklamën nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

NENI 11



Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Në asamble marrin pjesë të gjithë anëtarët themelues me të drejtë vote sipas shumave të vëna në kapitalin themeltar të shoqërisë. Asambleja e anëtarëve themelues kryen kvto funksione:

- Miraton Bilancin vjetor të shoqërisë.
- Vendors për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- Emëron dhe revokon Administratorin e shoqërisë.
- Kryen modifikime në statusin sipas ecurive të shoqërisë si dhe kontroll të shoqërisë.
- Vendors për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e saj me një tip tjetër shoqërie.

NENI 12

Administratori i shoqërisë përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë.

Shoqëria merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të vijë nga veprimet e kryera nga administratori.

Administrator emërohet **Znj. Olmo Doçi**, i biri i Shaqir dhe Lindita, lindur më 26.05.1987 në Shkoder dhe banues në Shkodër, shtetas shqiptar, me numër personal 1705260091 mandati i te cilit është 5 vjeçar me të drejtë riemërimi.

NENI 13

Anëtarët Themelues si dhe të gjithë anëtarët që do të pranohen si të tillë pranë shoqërisë duke përfshirë edhe bashkëpunëtorët e saj, detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë.

Të punësuarit, bashkëpunëtorët dhe të ngarkuarit me menaxhimin e shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen që të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Administratori dhe punonjësit kanë përgjegjësi individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontratën dhe rregulloren e shoqërisë, si dhe shkeljet e kryera nga ai gjatë administrimit të shoqërisë. Marrëdhëniet e punës me punëtorët që do të punësohen pranë shoqërisë "Dipingo Albania" rregullohen me kontrata individuale, që do të lidhen me secilin prej tyre.

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të lidhë kontratë bashkëpunimi dhe shërbimi me cdo individ apo shoqëri tjetër, brënda dhe jashtë vendit me qëllim realizimin e objektivave dhe veprimtarisë së shoqërisë.

KREU V

MBYLLJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

NENI 14

Shoqëria mund ti japë fund aktivitetit të saj dhe para afatit të përcaktuar në aktin e themelimit, me aprovimin e Asamblesë së Anëtarëve Themelues.

NENI 15

Kur shoqëria likujdohet plotësisht Asambleja krijon komisionin e likujdimit në të cilin paraqet bilancin e likujdimit. Pasuria e shoqërisë, pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, do të ndahet mes anëtarëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar. Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi i kthehet pronarit të saj.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 16

Në rast të lindjes së mosmarrëveshjeve për këtë kontratë që ka vlerën e aktit të themelimit të shoqërisë, do të zgjidhen nga vetë anëtarët themelues me mirëkuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Seksioni Civil i Gjykatës së Shkallës së Parë Shkoder.

Kontrata pasi u lexua nga Anëtarët Themelues u nënshkrua prej tyre.

ANËTARËT THEMELUES

Redi Doçi

Redi Doçi


Olmo Doçi

Olmo Doçi
